



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1060/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit, Muharrem Shtavica, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë-dega në Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1060/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit Muharrem Shtavica, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë-dega në Rahovec, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar Rinumërimin e votave në vendvotimet 1610A/01R, 1610A/02R, 1610A/03R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1060/2021, i ushtruar nga Muharrem Shtavica, për Kuvend Komunal, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën ndër të tjera ka pretenduar se në vendvotimet 1610A/01R, 1610A/02R, 1610A/03R, ka pasur parregullësi dhe mos përputhje të votave..

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, Muharrem Shtavica, kërkon rinumrimin e votave për vendvotimet e lartcekura. Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Muharrem Shtavica, Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, i njëjti nuk ka ofruar asnjë dëshmi qoftë formular apo deklarata të votuesëve, që dëshmojnë ato pretendime të cilat pretendon se nuk i kanë dalë votat, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se ka mungesë të votave në vendvotimet e lartcekura. Edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.1060/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.